



Gradanska alijansa
Civic Alliance - Aleanca qytetare

Viti i parë i Aleancës qytetare





Gradanska alijansa
Civic Alliance - Aleanca qytetare

Aleanca qytetare, Mali i Zi
shkurt, 2013.

Për botuesin
Boris Raoniq

Autorët e raporteve
Ekipi GA

Përkthimi dhe lektorimi
Aldina Rexha

Dizajni dhe faqosja
Aleksandar Pajeviq

Përpunimi dhe shtypja
AP print, Podgorica

Tirazhi 500 kopje

Specifikimi dhe përdorimi i informacionit nga ky raport, lejohet në botimet jo-fitimprurëse apo mediat informative, për qëllim të informimit të qytetarëve, si dhe për qëllime jo-komerciale, me kusht që të theksohen burimi dhe të drejtat e autorit. Përdorimi i materialeve për ndonjë qëllim tjetër nuk lejohet pa miratimin paraprak të Aleancës qytetare.

PËRMBAJTA

- 4 Vizioni–Misioni–Vlerat**
- 5 Aleanca qytetare: ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve**
- 6 Vizion i qartë: shoqëri civile dhe demokratike e bazuar në sundimin e ligjit**
- 8 Finansa transparente dhe administratë efikase**
- 9 Të hapur për komunikim dy–anësor me të gjithë**
- 14 Programi i të drejtave të njeriut**
- 16 Sundimi i programit ligjor**
- 20 Programi mediatik**
- 23 Programi i qeverisjes së mirë**
- 26 Të ardhurat dhe shpenzimet**
- 27 Donatorët**
- 27 Partnerët**
- 28 Të punësuarit**

Vizioni

Mali i Zi është një shoqëri civile dhe demokratike e bazuar në sundimin e ligjit. Mali i Zi po zhvillohet si një shoqëri me qytetarë aktivë dhe të informuar, ndërsa institucionet shtetërore po zhvillohen në përputhje me normat pozitive me interes publik.

Misioni

Aleanca qytetare (AQ) në mënyrë kualitative dhe efikase kontribuon në krijimin e shoqërisë civile dhe demokratike, nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve dhe mbështetjes ndaj iniciativave qytetare, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe kontrollimit të punës së institucioneve shtetërore.

Vlerat

E vërteta, drejtësia, paqja, toleranca, përgjegjësia, barazia, puna ekipore, aktivizmi, transparenca, bashkëpunimi, dhe të mësuarit e vazhdueshëm.



*Të dashur miq, të gjithë ju të cilët keni të njëjtin sistem vlerash si ne
Të dashur qytetarë, ata të cilët konsiderohen si të tillë,*

Para juve është raporti i parë vjetor për punën e Aleancës Qytetare, i formuar me bashkimin e organizatave lokale. Ideja për bashkimin e organizatave të përcaktuara mirë paraqet precedent në shoqërinë malazeze, ku ndarjet e vazhdueshme pengojnë përdorimin e drejtë të burimeve edhe ashtu të kufizuara. Në këtë mënyrë, kemi dashur të tregojmë se bashkimi principiel i vlerave lehtëson realizimin e tyre.

Viti i kaluar për ne ka qenë vit i formimit programor të bazuar në vlera, formimit të stafit dhe administratës.

Ne kemi përcaktuar mandatin dhe misionin preciz, kemi siguruar kushte stabile për funksionim, kemi miratuar plan të caktuar dy vjeçar, dhe vlera të qarta të pranuar nga të gjithë punonjësit. Ndaj dhe rezultatet nuk kanë munguar. Për më tepër, nëpërmjet procesit të krijimit të Aleancës Qytetare - ne kemi konfirmuar angazhimin tonë për zgjidhjen e problemeve të përditshme të qytetarëve - të cilët shpesh janë larg nga të gjitha ato konferenca zyrtare, seminare, komitete, këshilla, borde, metropole të mëdha dhe hotele të rehatshme, fjalëve të mëdha dhe ndryshimeve të vogla. Pra – problemet e njerëzve të zakonshëm që rrallë mund të ndjekin ritmin e ndryshimeve të suazave ligjore dhe institucionale malazeze në kuadër të integrimeve me rrjedhat në BE.

Në përputhje me vizionin tonë të qartë të shoqërisë civile dhe demokratike malazeze, të bazuar në sundimin e ligjit, gjatë vitit të kaluar, ne jemi marrë me aktivitetet në këtë fushë dhe nuk i kemi lejuar vetes të endemi jashtë kuadrit të përcaktuar, pa varësisht interesit të donatorëve.

Kështu, në këtë raport ju mund të lexoni për mënyrën se si gjatë vitit 2012 ne kemi kontribuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në çfarë mënyre kemi monitoruar funksionimin e institucioneve publike, si kemi fuqizuar kapacitetet dhe u kemi ofruar mbështetje iniciativave qytetare, si kemi komunikuar me qytetarët dhe në ç'mënyrë u kemi dhënë atyre ndihmë të drejtpërdrejtë.

Transparenca dhe përgjegjësia janë gjërat që ne kërkojmë nga të gjitha institucionet publike, por ne gjithashtu i çmojmë ato si një nga vlerat tona thelbësore, dhe për këtë arsye, paraqesim këtë raport.

Shpresojmë se do të vazhdojmë bashkëpunimin e mirë me të gjithë ju në vitin 2013.

Me respekt,

Ekipi i Aleancës Qytetare

**Strategjia, Programet
Administrimi, Komunikimi**

Aleanca qytetare: Ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve

Aleanca Qytetare u formua si rezultat i idesë për bashkimin e organizatave dhe individëve të cilët çmojnë vlerat e njëjta dhe janë të përfshirë në zgjidhjen e problemeve të njëjta. Nëpërmjet programeve të rregullta, aktivistët tanë me vite të tëra drejtpërdrejtë komunikojnë me qytetarët e Malit të Zi, duke i ndihmuar ata, në suazat e potencialit dhe motiveve të sinqerta të tyre, për të zgjidhur problemet që lidhen me shkeljet e të drejtave të njeriut, joefikasitetin e institucioneve publike dhe procedurat e ndërlikuara ligjore.

Idea jonë ishte të përforcojmë efektin sinergjik të programit mediatik dhe tv programit “Robin Hood”, të organizimit 35mm dhe kapaciteteve të YIHR, lidhur me monitorimin e institucioneve publike dhe ndihmës juridike, duke konsoliduar njëkohësisht segmentet administrative dhe finansiare. Në këtë mënyrë u krijua korniza operative e programit për lidhjen e ndërsjellë të aktiviteteve tona - informatat e mbledhura gjatë programeve të monitorimit të drejtpërdrejtë dhe ndihma juridike ofruar gazetarëve të “Robin Hood” për hulumtim dhe prezantim në media. Në të njëjtën kohë, informacioni i gazetarëve dhe konkluzionet e diskutimeve të tyre me zyrtarët publik janë përdorur nga ekipet tona monitoruese dhe juridike, në mënyrë që nga mbledhja e mëtejshme e informatave konkrete në terren të vërtetojmë se në çfarë mase këto probleme kanë karakteristika sistematike.

Me këtë qasje, ne kemi dashur të fusim një dozë të re energjie në gjithë historinë mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e cila në mjedisin tonë shoqëror ka marrë karakteristikat kryesisht të fjalëve boshe burokratike apo të një mjeti pazarllëku në debatet e vazhdueshme dhe të kota publike. Në fakt, në situata të këtilla, shpesh neglizhohet fakti se pas gjithë këtyre shkeljeve të të drejtave të njeriut apo treguesve statistikorë, qëndrojnë njerëz të zakonshëm me probleme të cilat pengojnë jetën e tyre të përditshme, duke filluar nga tortura policore, procedurat e stërgjata gjyqësore ose procedurat e komplikuar për marrjen e vendimeve në financimin e ndërhyrjeve mjekësore. Aktivistët e Aleancës Qytetare, gjatë periudhës së kaluar, kanë pasur kontakte të tilla të shumta me qytetarët, duke u përpjekur që t’u sigurojnë atyre ndihmën e përshtatshme, kryerjen e gati të gjysmës së aktiviteteve të tyre të projektit mbi baza vullnetare.

Nëpërmjet shembujve të veçantë të problemeve të qytetarëve tanë, Aleanca

Qytetare ka arritur të identifikojë problemet sistemike që pengojnë plotësimin e interesave të tyre themelore ose lejojnë (pa-ndëshkuar) shkeljen e të drejtave të tyre të njeriut. Përmes raporteve tona të monitorimit, këto probleme u transferuan në udhëzime të qarta për zgjidhjen sistematike të këtyre problemeve, dhe iu prezantuan partnerëve në opinionin publik, sektorit të OJQ dhe media-ve, në mënyrë që ato të zgjidhen si duhet.

Gjatë këtij viti, ne do të shënojmë dhjetë vjetorin e Shkollës së Leadershipit Demokratik, shtatë vjetorin e emisionit “Robin Hood”, gjashtë vjetorin e monitorimit të të drejtave të njeriut dhe dy vjetorin e monitorimit të sistemit gjyqësor, të cilat janë projekte tona më të mirënjohura. Nëpërmjet këtyre projekteve, Aleanca Qytetare bëri çmosin për të identifikuar problemet kyçe të sistemit, për të ndihmuar qytetarët e zakonshëm, por edhe për të sjellë më afër atë se çfarë fshihet pas fjalëve të mëdha, siç janë Sundimi i Ligjit, Transparenca dhe Qeverisje e Mirë, mbi të cilat flitet vazhdimisht në të gjitha konferencat, koktejet, tryezat e rrumbullakta dhe të gjitha ato hotele të rehatshme dhe destinacione ndërkombëtare prestigjioze.

Dhe ky është kufiri, të cilin shumë pak nga të punësuarit tanë nga të gjitha segmentet e shoqërisë, duan ta kalojnë. Ky është pikërisht kufiri, përtej së cilit qytetarët tanë na presin ne, me problemet dhe çështjet e tyre jetike për të cilat ne duhet patjetër të reagojmë, sepse masa e zgjidhjes së problemeve të tyre do të jetë masa e suksesit të reformave tona.



Boris Raoniq, president i AQ

Vizion i qartë: shoqëri civile dhe demokratike bazuar në sundimin e ligjit

Shoqëria civile dhe demokratike malazeze e bazuar në sundimin e ligjit - një vizion me të cilin jemi udhëhequr gjatë përcaktimit të programit tonë. Në këtë vizion, qytetarët janë aktiv dhe të informuar, ndërsa institucionet publike funksionojnë në përputhje me legjislacionin pozitiv dhe synojnë të përmbushin interesin publik. Të udhëhequr nga ky vizion, ne kemi krijuar planin strategjik për periudhën 2012-2013, nga i cili rrjedhën të gjitha aktivitetet programore të Aleancës Qytetare të realizuara gjatë këtij viti (Plani strategjik dhe dokumentet tjera relevante mund t'i gjeni në faqen tonë të internetit [www.gamn.org / dokumenti.html](http://www.gamn.org/dokumenti.html))

Aleanca Qytetare dukshëm ka fuqizuar kapacitetet e veta dhe sot secili prej katër programeve udhëhiqet nga Koordinatori - person i aftë dhe me përvojë në këtë fushë. Rreth vetes ne mbledhim edhe një numër aktivistësh të rinj të cilët janë të gatshëm të punojnë në mënyrë direkte mbi ndryshimet pozitive në shoqëri. Të gjithë ne vazhdimisht punojmë në përmirësimin e kompetencave tona për t'u marrë me këtë punë dhe e konsiderojmë atë si marrëdhënie të përgjegjshme ndaj qytetarëve në emër të të cilëve ne shpesh punojmë.

Kur shikojmë pas në atë që kemi arritur në vitin 2012, ne veçanërisht krenohemi për partneritetin dhe bashkëpunimin e mirë që kemi krijuar me organizatat dhe shoqatat tjera të cilat ndajnë vlerat tona dhe me punën e tyre kontribuojnë në vizionin tonë. Ne kemi themeluar komunikimin dhe, në anën tjetër, bashkëpunimin me institucionet në sferën me të cilën merremi. Në këtë mënyrë, hetimet toma drejtpërdrejtë i prezantohen personave përgjegjës dhe përmes programeve mediatike dhe përmes bashkëpunimit me mediat në mënyrë adekuate dhe në mënyrë efektive informojmë publikun. Ka edhe shumë punë për të gjithë ne derisa të rezultojnë ndryshime të përmirësuara sistemike - qëndroni me ne edhe në periudhën e ardhme.



Ajsha Haxhibegović, Drejtor i programit AQ

Finansa transparente dhe administrim efikas

Duke pasur parasysh se vetëm një vit ka kaluar që nga themelimi i Aleancës Qytetare, kemi arritur që gjatë kësaj periudhe të krijojmë një administratë efikase, e cila kryesisht ofron mbështetje të programeve përmes punës të përmirësuar dhe lidhjeve më të mira programore.

Toleranca, përgjegjësia, barazia, puna ekipore, transparenca, mësimi konstant, bashkëpunimi, janë vlerat të cilat ne i afirmojmë në komunikimin e përditshëm me njëri-tjetrin, por edhe në komunikimin me bashkëpunëtorët tanë të ngushtë. Për këtë arsye, AQ është njohur nga të tjerët për atmosferën e saj pozitive dhe punën ekipore.

Financat e AQ janë publike dhe çdo raport vjetor financiar është i paraqitur në faqen e internetit të organizatës. Edhe pas krijimit, u zhvilluan konsultime me organizatat partnere dhe organizatat gjegjëse, në mënyrë që të vihet deri te zgjidhja më e mirë për nevojat e organizatës sonë. Auditimi i parë doli me sukses, gjë që justifikoi modelin e krijuar administrativ dhe financiar.

Me anëtarët e saj AQ ka arritur që vetëm për një vit të lidh më shumë se 15 partneritete me donatorë të ndryshëm të cilët kanë njohur entuziazmin dhe misionin e AQ. Mbështetja IT funksionon pa asnjë problem, ndërsa faqja e internetit të AQ është një nga të paktat që funksionon në tri gjuhë.

Në të ardhmen, ne posaçërisht do t'i dedikohemi idesë së qëndrueshmërisë së AQ, si sfidën më serioze të kësaj organizate tashmë të madhe.



Edina Hasanaga Çobaj, Drejtor egzekutiv i AQ

Të hapur për komunikim reciprok me të gjithë

Që nga fillimi i aktivitetit publik, AQ ka profilizuar veten si OJQ që është e hapur për bashkëpunim me të gjitha mediat, që është një angazhimi logjik, pasi ajo është

e vetmja në Mal të Zi e cila ka programin e vet kompleks mediatik. Ne mbajmë epitetin e një organizate objektive dhe të hapur sepse i qasemi komunikimit me media nga kënde të ndryshme: monitorojmë nevojat e qytetarëve dhe institucioneve me të cilët punojmë, dhe në bazë të këtyre të dhënave përcjellim mesazhe të sakta dhe të fuqishme, pra duke i konvertuar ato në gjëra me rëndësi të përgjithshme dhe nëpërmjet programit mediatik ne përdorim kanalet në mënyrë që të ndryshojmë politikat publike. Në këtë mënyrë, ne përpiqemi, si një lloj korigjuesi, të ndihmojmë gjithë qytetarët të cilët nuk arrijnë të përfitojnë interesimin e institucioneve adekuate mbi problemet e tyre, ose të marrin më shpejtë informacionin e nevojshëm nga fusha e organeve publike. Gjithashtu, në këtë mënyrë ne lejojmë përfaqësuesit e sektorit publik të paraqesin aktivitetet e tyre ose të adresojnë problemet e identifikuar, t'u përgjigjen ankesave të qytetarëve dhe të sqarojnë vizionin e tyre të gjërave.

Punonjësit e AQ gjithnjë e më shumë duken si komentues të ngjarjeve kryesore shoqërore që bien brenda mandatit të tyre, kështu që çdo anëtar i organizatës sonë është aktiv, ndaj, fokusi nuk është vetëm te “udhëheqësi”, si zakonisht ndodh në organizatat jo-qeveritare. PR i shkëlqyer është fakti se anëtarët tanë janë pjesëmarrës në organet që janë krijuar për përgatitjen më të mirë për negociatat mbi kapitujt e pranimit të BE-së.

Ne jemi veçanërisht krenarë për produktet tona mediatike, ku posaçërisht dallohet një nga programet më të shikuara të prodhimit vendor - “Robin Hood”, i cili pati sezonin e tij të gjashtë dhe të shtatë në shërbimin publik të RTCG (Strategic Marketing Research e rendit atë mu pas Lajmeve qendrore dhe programit të mëngjesit). Ne besojmë se kjo është një lëvizje e suksesshme dhe pioniere, sepse ky është seriali i parë në historinë televizive i cili realizohet si bashkë-prodhim mes Televizionit kombëtar me një OJQ. Ne vlerësojmë se vetë ky veprim është një lëvizje logjike, sepse një program i tillë ishte i nevojshëm për shërbimin publik, dhe në anën tjetër, RTCG është platforma ideale për mesazhin dhe misionin e programit “Robin Hood”, sepse, përveç audiencës në shtëpi, programi shikohet

përmes satelitit dhe gjen hapësirë edhe në kanalin YouTube. Megjithatë, fillimi i sezonit të parë u vonua papritur për disa arsye: transferimi nga INTV dhe nga një sërë mosmarrëveshesh administrative dhe kontraktuale me grupin menaxherial të vjetër / të ri në RTCG. Këto arsye në mënyrë të dukshme nxorrën në pah faktin se nga disa anëtarë të Këshillit të RTCG, të cilët, çuditërisht, përfaqësonin sektorin e OJQ-ve, kemi pasur obstruksione të drejtpërdrejta në nënshkrimin e një Kontrate mbi bashkëprodhimin.

Në të njëjtën kohë, prania jonë është më intensive në internet, nëpërmjet portalit www.ebalkan.net, e cila ka publikë të profilizuar në të gjithë rajonin dhe çdo muaj ka dhjetra e mijëra vizitorë.

Së fundi, politika mediatike e balancuar dhe transparente ka rezultuar në faktin se ka vlerësime të pamatshme: ne nuk njihemi si pjesë e ndonjë lobi në shoqërinë malazeze dhe bashkëpunimi me të gjitha mediat në Mal të Zi është më i mirë se kurrë.

Nga fillimi, websiti www.gamn.org, regjistron një numër konstant të vizitorëve, dhe gjatë këtij viti u krijuan sub-faqet për Shkollën e Lidërshiptit Demokratik (www.sdr.gamn.org), Shkolla Virtuale e Lidërshiptit Demokratik (www.vs.gamn.org), për emisionin televiziv “Robin Hood” (www.gamn.org / Robinhood), pastaj në lidhje me pjesëmarrjen në një grup punues për hartimin e strategjisë përbashkëpunimi me organizatat jo-qeveritare (www.gamn.org / RazvojNVO) si dhe për procesin e monitorimit të të drejtave të njeriut në përputhje me sistemin e OKB-së të Raportit Periodik Universal (UPR) (www.gamn.org / UPR).

Pa llogaritur programet mediatike të cilat janë pjesë e produksionit tonë, është e rëndësishme të theksohet se në vitin 2012, AQ kishte mbi 1.300 paraqitje mediale, duke e bërë atë një nga tre OJQ-të më aktive në Mal të Zi.



Darko M. Ivanoviq, Drejtor i komunikimeve të AQ

PROGRAMET TONA

Programi i të Drejtave të Njeriut



Problemi më i vështirë që paraqitet në kuadrin e programit të të drejtave të njeriut është numri i madh i rasteve të raportuara të shkeljes së të drejtave të njeriut, ku nuk janë bërë hetime urgjente, efikase, dhe të pavarura. AQ kërkon dhe bën presione mbi institucionet publike të cilat akoma janë të mbyllura, për të kryer hetimet. Programi për të drejtat e njeriut përfshin monitorimin e cilësisë së zbatimit të ligjit, si dhe hulumtimin dhe dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, përpunimin e tyre dhe përfaqësimin e viktimave para gjykatave kompetente dhe organeve publike përmes aktiviteteve të ndihmës juridike falas. Programi i të drejtave të njeriut është i fokusuar në ballafaqimin me të kaluarën, problemet e diskriminimit dhe torturat, dhuna e motivuar politikisht, liria e shprehjes, liria e shoqërimit dhe tubimit, mbrojtja e të dhënave personale, liria e fesë, të drejtat e pakicave, Statusi i personave të zhvendosur, të drejtat ekonomike dhe sociale.

Vetëm gjatë vitit 2012, ne kemi regjistruar 20 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut në fusha të ndryshme dhe kemi ofruar ndihmë ligjore falas në lidhje me këto raste. Aleanca Qytetare është duke finalizuar Raportin e plotë analitik, i cili do të përmbledhë

aktivitetet e gjashtë viteve të kaluara, që nga pavarësia e Malit të Zi deri në fillim të negociatave për anëtarësimin në BE. Sipas numrit të madh të rasteve të raportuara dhe të perceptuara të shkeljes së të drejtave të njeriut në Mal të Zi, në periudhën 2006 - 2012, raporti do të përpiqet të paraqesë karakteristikat kryesore të sistemit të mbrojtjes institucionale të të drejtave të njeriut, nga policia, gjyqësori deri te Avokati i Popullit dhe Parlamenti. Ky dokument do të jetë pasqyrë e qartë e situatës në vendin tonë dhe e punës së institucioneve publike, tendencat e zhvillimit, avantazhet dhe disavantazhet, dhe si të tilla do të shërbejë si bazë për Aktivitetet tjera të AQ në këtë fushë.

AQ aktivisht kontribuon në procesin e Rishikimit Periodik Universal (UPR) të gjendjes së të drejtave të njeriut. AQ ka marrë pjesë në hartimin e raportit kombëtar të Qeverisë. Ne kemi marrë pjesë në zhvillimin e raportit për të drejtat e fëmijëve, dhe në nëntor 2012, pjesëmarrësit tanë përfaqësuan gjendjen e të drejtave të njeriut në para-seancën për misionet e interesuara. Në bashkëpunim me OJQ-CEDEM, në fund të vitit, ka filluar projekti “Fuqizimi i shoqërisë civile për pjesëmarrje aktive në procesin UPR”. U krijua koalicioni prej shtatë organizatave joqeveritare të cilat do të fuqizojnë kapacitetet dhe aktivisht do të monitorojnë implementimin e rekomandimeve gjatë vitit 2013.

Teknikat e hulumtimit në terren, press clipping, analiza ligjore, intervista, linja telefonike SOS dhe analiza e raporteve zyrtare të institucioneve publike dhe organizatave tjera janë përdorur përmes programit të të drejtave të njeriut.

Kur është fjala për aktivitetet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ne jemi të vetëdijshëm se termat e komplikuar apo raportet sipërfaqësore, burokratike dhe statistikore shpesh nuk japin një pasqyrë të qartë të natyrës së vërtetë të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe efekteve që kanë në jetën e njerëzve të zakonshëm. Vetëm me anë të rasteve të detajuara dhe të dokumentuara lexuesit mund të fitojnë një imazh të seriozitetit dhe pasojave të këtyre rasteve, kompleksitetit të aktiviteteve për të mbështetur viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre. Kjo mund të ilustruhet me shembullin e rastit “Shoshkiq”. Hetimi i këtij rasti u shty për katër vite. Në këtë rast u tha se oficerët e policisë ishin përgjegjës për torturimin dhe vdekjen e Miroslav Shoshkiq-it nga Berana, i cili vdiq në dhjetor 2008, pas një ndjekjeje nga ana e policisë. Hetimi u mbyll fillimisht dhe incidenti u shpall si një aksident. Mbështetja për prindërit dhe këmbëngulja e AQ nëpërmjet komunikimit të përditëshëm me institucionet sollën deri te hapja e hetimeve të reja në nëntor 2012, dhe për shkak të dyshimit se janë përgjegjës për vdekjen e Shoshkiq, dy oficerë policie u privuan nga liria në fund të vitit 2012.

Gjithashtu, bazuar në monitorim dhe në vet rastet, nga koha e raportimit deri te vendimi i gjykatës, AQ në bazë të numrit të madh të informacioneve ka arritur të identifikojë problemet kryesore të sistemit në punën e institucioneve publike. Megjithatë, ajo që

shkakton shqetësim është se, sipas të dhënave tona dhe analizave mbi bazën e raportit mbi punën e institucioneve shtetërore, vetëm rreth gjysma e rasteve të raportuara të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut është penalizuar. Institucionet e mbyllura e vështirsojnë dukshëm punën e shoqërisë civile. Në punën e saj, AQ përdor mundësinë e marrjes së informacionit sipas Ligjit për qasje të lirë në informata. Megjithatë, një numër i madh i institucioneve nuk veprojnë sipas kërkesave të paraqitura nga sektori joqeveritar. Një nga shembujt e praktikës së tillë është veprimi i Gjykatës Themelore në Kotor, e cila nuk lejoi kontrollimin e aktgjykimeve me të cilat oficeri i policisë u dënua tri herë për shkak të shkeljeve duke vepruar në kapacitetin zyrtar, duke shpjeguar se në këtë mënyrë do të rrezikohej mbrojtja e privatësisë së atij oficeri të policisë. Mirëpo, në këtë rast as animizimi i vendimit nuk do të ketë kuptim, sepse ne e dimë kujt i është dhënë ai aktgjykim. Për veprime të tilla të cilat janë konfirmuar nga Ministria e Drejtësisë, AQ ka paraqitur pretendimet në Gjykatën Administrative prej së cilës presim të bëjë publike vendimin e këtij rasti sipas parimit të praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në përvojën tonë, Fondi për ushtrimin e të drejtave të pakicave është gjithashtu një institucion që nuk respekton Ligjin për qasje të lirë në informata, i cili është i mbyllur dhe ka numër të madh të parregullsive – fakt i njohur për një numër të institucioneve publike, Komisionit Evropian, mediave dhe OJQ-ve. Për punën e tillë të Fondit, AQ ka ngritur dy padi kriminale, ankesa në Gjykatën Administrative dhe ka dërguar shumë letra në Qeveri dhe Parlament për të rregulluar funksionimin e Fondit në përputhje me Ligjin.

Nga ana tjetër, ka institucione të cilat janë të hapura për bashkëpunim me AQ dhe si një shembull pozitiv mund të përmendim Byronë për ekzekutimin e sanksioneve penale, ku në komunikimin e përditshëm me Menaxhmentin e ZIKS, përfaqësuesit e AQ zgjidhin problemet e personave të privuar nga liria.



Milan Radović, Koordinator i Programit mbi të drejtat e njeriut

Programi i Sundimit të Ligjit



Nëpërmjet këtij komponenti të programit, Aleanca Qytetare tenton të transferojë të gjitha përvojat nga puna me rastet individuale të shkeljes së të drejtave të njeriut, ose thjesht me problemet jetësore të qytetarëve dhe marrëdhënieve të tyre me institucionet publike, në udhëzues të qartë, në mënyrë që të largojë çdo supozim të sistemit për rihapjen e rasteve. Në lidhje me këtë, AQ me vëmendje të veçantë ka përcjellur punën e gjykatës dhe sistemin e kujdesit primar shëndetësor, duke marrë parasysh intensitetin dhe përmbajtjen e ndërveprimit të qytetarëve të rëndomtë dhe kësaj pjese të sistemit publik.

Gjatë monitorimit të institucioneve publike, mbi të gjitha, gjykatave themelore dhe qendrave të kujdesit shëndetësor, më vonë edhe spitalet, është regjistruar numër i madh i dështimeve në punën e tyre. Në sajë të monitorimit tonë, mu pas shpalljes së parë publike të një situate të tillë dhe duke cekur parregullsi të shumta, u bë përparimi i parë i rëndësishëm në punën e këtyre institucioneve. Ne duam të theksojmë se të gjitha rezultatet e projektit të monitorimit u prezantuan në institucionet përkatëse me qëllim që të marrim pikëpamjet dhe përgjigjet e tyre. Domethënë, ne në AQ be-

sojmë se nuk mjafton vetëm të identifikohet një problem në punën e institucioneve publike, por gjithashtu është e rëndësishme të bëhen përpjekje, me anë të dialogut konstruktiv, për të ardhur deri te zgjidhja sistematike, e pranueshme për të gjithë partnerët dhe e qëndrueshme në mjedisin tonë shoqëror dhe kulturor.

Edhe pse sistemi gjyqësor është nën shqyrtim të vazhdueshëm publik, kryesisht në lidhje me rezultatin e rasteve individuale dhe nivelin e ndikimit të strukturave politike në punën e tyre - shumë pak vëmendje i kushtohet atyre kërkesave të sistemit dhe burimeve për punën cilësore të gjyqtarëve. Në fakt, gjatë monitorimit të efikasitetit dhe transparencës së sistemit gjyqësor, AQ ka gjetur një mospërputhje të madhe në mes të mbingarkesës së gjyqtarëve me një numër të rasteve, burimet e pamjaftueshme në dispozicion për gjyqtarë, dhe kushtet materiale të sistemit në përgjithësi. Përveç koordinimit të pamjaftueshëm me institucionet e tjera dhe organizimit të brendshëm, si dhe problemet që lidhen me aksesueshmërinë e informatave dhe marrëdhënieve me gazetarët, AQ është në procesin e formulimit të një sërë rekomandimesh të qarta, të cilat do t'u paraqiten përfaqësuesve të gjyqësorit, në mënyrë që përmes dialogut publik të dalë me një zgjidhje.

Ne gjithashtu kemi theksuar dështimet dhe kemi përmirësuar punën e ekspertëve, të cilët në ditët e sotme rregullisht dorëzojnë raporte, gjë që është thelbësore për pasqyrimin e aktgjykimeve. Ne poashtu kemi ndikuar në bashkëpunimin më të mirë të policisë dhe gjykatave që me forcë të sillen në gjykatë njerëzit të cilët i kërkon gjykata. Ne gjithashtu kemi potencuar nevojën për ndryshime kushtetuese të cilat u gjetën edhe në opinionin e Komisionit Evropian mbi Malin e Zi. Sa i përket monitorimit të sistemit shëndetësor, për shembull, u vërejt se mbi 60% e punëtorëve shëndetësorë nuk mbajnë kartat e identifikimit. Pas prezantimit publik të raportit dhe vënies së kësaj çështjeje në praktikë, gjatë raundit të ardhshëm të monitorimit, më shumë se 70% e tyre mbante kartë e identifikimit. Gjithashtu, në raundin e parë të monitorimit - nuk ka pasur deklarata rreth mbrojtjes së të drejtave të pacientëve, as kuti për ankesa në vende të dukshme, por në raundin e dytë, ky lëshim ishte korigjuar në masë të madhe.

Përmes këtij programi, ne po zbatojmë kontrollin e punës së institucioneve publike duke monitoruar punën e tyre në terren, edhe me ndihmën e analizës së raporteve dhe informatave në dispozicion. Gjatë vitit 2012, ne kryesisht jemi marrë me gjyqësorin sistemin shëndetësor. Rezultatet që marrim nëpërmjet monitorimit janë pika jonë e nisjes dhe baza për çfarë duhet të ndryshohet dhe të përmirësohet, por edhe të vlerësohet si shembull për organet tjera.

Ndarja e pushteteve, epërsia e ligjit, qasja e lirë në gjyq, gjykim i drejtë, dhe një gjy-

kim në një kohë të arsyeshme, barazia para ligjit dhe mbrojtje e barabartë nga ligji, vartësia e Qeverisë dhe e institucioneve publike ndaj – Kushtetutës, janë busull me të cilën programi i sundimit të ligjit tregon dhe paralajmëron kur dilet nga kursi.

Përmes programit të sundimit të Ligjit, kemi theksuar zbatimin e dobët të tij për asistencë juridike falas. Ne kërkuam përfshirjen më të mirë të gjyqtarëve në popullarizimin e këtij ligji dhe rolin aktiv të avokatëve. Ne gjithashtu theksuam koordinimin e dobët në mes gjykatave dhe institucioneve (Administrata Tatimore), ku gjykatat marrin dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e ndihmës juridike.

Kur është fjala për ligjin mbi të miturit, AQ ka theksuar faktin se nuk ka pasur dhoma të veçanta për marrjen në pyetje të të miturve, ndonëse zbatimi i ligjit ka filluar në shtator 2012. Ne theksuam mungesën e një ekipi të veçantë të njerëzve (psikologë, punonjës socialë, edukatorë), të cilët do të punonin në Gjykatat e Larta dhe Zyrat e Prokurorisë Supreme Publike në mënyrë që të sigurojnë opinione profesionale, deklarata dhe asistencë tjera në trajtimin e të miturve. Në lidhje me Ligjin për ekspertët, kemi kërkuar kontroll të punës së ekspertëve dhe masa më efikase për iniciimin e fillimin e procedurave mbi përgjegjësitë e tyre. Ligji për zbatuesit publik të rendit ka mbetur vetëm shkronjë në letër dhe është tregues se Mali i Zi miraton ligje shumë më shpejt sesa i zbaton ato.

Kryetarët e Gjykatave Themelore dhe Ministri i Shëndetësisë njohën organizatën tonë si një partner të besueshëm, ndërsa raportet tona, siç thanë, i ndihmuan ata në zbulimin e problemeve dhe përfundimisht në eliminimin e tyre, gjë që dha rezultate ciklike për ciklin e monitorimit. Inercioni, pengimi, neglizhenca dhe dështimi për të vepruar sipas raporteve dhe iniciativave tona ishin problemet me të cilat përballemi në punën tonë të përditshme me institucione publike specifike dhe me njerëzit në këto institucione.

Koha para neshë do të tregojë nëse Mali i Zi vërtetë ka kapacitet administrativ dhe teknik për të miratuar por edhe për të zbatuar një numër të madh të ligjeve që janë duke pritur për arsye të harmonizimit të legjislacionit të BE me legjislacionin tonë.



Zoran Vujić, Koordinator i Programit të Sundimit të Ligjit

Programi Mediatik



Në vitin 2012, ekipi i “Robin Hood” zgjidhi 72 probleme të raportuara nga qytetarët e Malit të Zi. Deri në ditët e sotme, pothuajse 30% e rasteve janë zgjidhur me sukses, dhe ne do të vazhdojmë të monitorojmë rastet e mbetura deri në zgjidhjen përfundimtare, duke i paralajmëruar institucionet në mënyrë konstante që të kryejnë punën e tyre me ndërgjegje, duke u kërkuar përgjigje konkrete dhe përgjegjësi për rastin aktual. Në vitin 2012, më së shumti ankesa kemi marrë nga veriu i Malit të Zi, madje 40%. Pak më pak, ose 30% e problemeve erdhën nga jugu. Përqindje e njëjtë e qytetarëve të pakënaqur është nga kryeqyteti. Risia është se në vitin 2012, kërkuan ndihmë edhe njerëzit jashtë shtetit. Ne u dhamë përparësi problemeve sociale të qytetarëve, sepse besojmë se ky lloj i problemeve është veçanërisht i theksuar në periudhat e tranzicionit shoqëror dhe politik, po ashtu edhe në krizën e tanishme ekonomike. Ne besojmë se problemet e këtilla të qytetarëve individualë, padrejtësisht, rrallë janë në fokusin e organizatave jo-qeveritare, të cilat kryesisht janë të orientuara në problemet ligjore apo strategjitëe publike. Në këtë drejtim, ne kemi kërkuar përgjegjësi të veçantë në rastet që kanë të bëjnë me veprimet e pandërgjegjshme të punëtorëve mjekësor. Nuk ka qenë e pazakon-

shme që pas intervenimit tonë, bashkëveprimi i sektorit publik me sektorin privat të ndryshojnë fatet e njeriut.

“Robin Hood” është magazinë shoqërore, javore, e cila kryesisht bazohet në parimin e gazetarisë “civile”. Temat e hulumtimeve janë të tilla që lidhen drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve dhe me qëllim të zgjidhjes së tyre, ky magazin është në dispozicion direkt në shërbim të qytetarëve dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Nëpërmjet një linjeje të hapur, e-mail, Facebook-ut dhe letrave që na vinë në zyrë, qytetarët çdo ditë raportojnë mbi problemet që ata kanë me institucionet e sistemit. Problemet përpunohen në formë të një video – lajmi i cili paraqitet në publik, dhe pas kësaj në studio të japë përgjegjësi, ftohet funksionar i qeverisë shtetërore ose lokale i cili duhet të zgjidh problemin. Nga njëra anë, “Robin Hood” jep kontribut konkret dhe konstruktiv në krijimin e shërbimeve publike shumë më efikase, e nga ana tjetër gjithashtu siguron një depërtim unik në thelbin e problemeve të qytetarëve, mënyrën e funksionimit të organeve publike dhe në mekanizmat ligjore që janë në dispozicionin tonë.

“Robin Hood” ia ka dedikuar katër emisione tematike sistemit të kujdesit shëndetësor dhe fushës së gjyqësorit - për të cilat është vërejtur se kanë dështime dhe shkelje të ligjit më të shpeshta. Në 26 institucione shëndetësore dhe 6 gjykatat themelore, monitoruesit e Aleancës Qytetare kanë kaluar mbi 2000 orë. Të dhënat kanë ardhur nga 15 qytete në Mal të Zi. Nëpërmjet TV show “Robin Hood”, publiku malazez kishte akses të drejtpërdrejtë në rezultatet e monitorimit të Aleancës Qytetare. Ne patëm mundësi të njoftojmë drejtuesit e institucioneve që kontrolloam, me dështimet që pengojnë funksionimin e sistemit gjyqësor dhe kujdesin shëndetësor. Nëpërmjet komunikimit publik me personat kompetentë në këtë fushë, Aleanca Qytetare është përpjekur që të vihet deri te zgjidhja dhe shpjegimet konkrete, ndërsa monitorimi ka rezultuar në mënyrë që në këto fusha janë arritur përmirësime të konsiderueshme.

Rruga nëpër të cilën shkel “Robin Hood” në mënyrë të sigurt, ka pasur pengesa. Institucionet të cilat seriozisht kanë devijuar nga rregullat e përcaktuara të parapara me ligj, kur bëhet fjalë për qasjen e lirë në informacion janë: Prokuroria, Gjykata Ekonomike, kryeqyteti. Nga ana tjetër, shumica e institucioneve kohë pas kohe bëjnë punën e tyre.

Pjesa online e programit mediatik të Aleancës Qytetare, portali E-Balkan, për pothuajse dy vjet promovon të menduarit kritik mbi ngjarjet aktuale dhe mbi të ardhmen, pajtimin rajonal dhe bashkëpunimin. Portali tashmë ka profilizuar audiencën, e cila rregullisht viziton faqet e gazetës online dhe profilet në rrjetet sociale-

Twitter dhe Facebook.

Nga janari deri në dhjetor 2012, ka pasur 210.710 vizitorë unik. Shumica e tyre u bë në shkurt - 38.644, dhe vizita më e ulët ishte në korrik - 11.124. Shumica e vizitorëve janë nga Mali i Zi - 38,61%, më pas vinë vizitorët nga Serbia fqinje - 21, 45%, dhe Kroacia - 12, 22%.

Në faqen e saj www.e-balkan.net, Aleanca Qytetare ka botuar 50 artikuj individuale mbi grupet e marginalizuara në 2012 (njerëzit me aftësi të kufizuara, LGBT, popullsisë RAE), publikuar nga mediat e tjera. Suksesin më të madh e arriti teksti i Raul Kevrić - "Pse nuk e kam dëgjuar Niko Vujicic" - me 16.794 klikime në <http://e-balkan.net/fokus/16794-zato-nisam-sluao-nika-vujicia.html>, të cilin e publikuan edhe portalet Enovine, Vesti.rs, Indeksi i 6uka.



Marina Bauk, Koordinator I programit mediatik



Milica Gjokgjuriq, Konsulent për komunikime

Program i Qeverisjes së mire



Pas dhjetë gjeneratave të Shkollës së Liderit Demokratik dhe dy vitesh pune me alumni, SLD arriti të krijojë rrjetë të fortë të mbi 200 alumni. Prandaj, ne kemi zhvilluar një kapacitet për të kuptuar dhe për pjesëmarrje aktive të alumnit në proceset aktuale demokratike, të cilat u ofrojnë kontribut unik në kuadër të detyrave dhe funksioneve të tyre. Rrjeti SLD aktualisht ka mbi 20 deputetë në përmbajtjen aktuale të Parlamentit, numër i madh i figurave kryesore të shoqërisë civile, komuniteteve fetare, redaktorëve të mediave më të njohura, etj

Në kuadër të Programit të Liderit Demokratik, këtë vit, SLD, e cila është anëtare e Shoqatës Evropiane të Shkollave për Studime Politike, vazhdoi punën e saj. Gjatë vitit 2012, Shkolla është fokusuar në punën me të diplomuarit e dhjetë gjeneratave të mëparshme.

Me 20 përfaqësuesit e saj, Shkolla mori pjesë në Forumin Global për Demokraci që u mbajt në muajin tetor në Strasburg. Shkolla e Lidërshipt Demokratik ka adoptuar aktivitete në vitin 2012 për të rritur kapacitetin e alumni, kur është fjala për kulturën demokratike dhe proceset në Mal të Zi. Në këtë drejtim, AQ synon të të fuqizojë pikërisht elementin që i mungon shoqërisë në Mal të Zi - dhe kjo është një dialog i hapur dhe konstruktiv në mes të grupeve dhe individëve të ndryshëm që kanë mendime të ndryshme, por me qëllim që energjia, njohuria dhe përvoja prezente në shoqërinë malazeze të drejtohet kah formulimi i zgjidhjeve të qëndrueshme.

Kështu AQ, përmes bashkëpunimit të SLD dhe Agjensinë gjermane për zhvillim-GTZ, nisi një dialog për efikasitetin energjetik në Mal të Zi. Vëmendje e veçantë iu kushtua fuqizimit të dialogut në mes të përfaqësuesve të partive politike, medias, shoqërisë civile dhe sektorët të biznesit, të identifikuar si partnerë kyç për promovimin e mëtejshëm të dialogut dhe politikave adekuate në këtë temë.

Në kuadër të Programit të Lidërshipt Demokratik, AQ monitoroi keqpërdorimin e automjeteve zyrtare, sidomos keqpërdorimin e funksioneve publike dhe burimeve për qëllime para-elektorale. Pas referencave të vazhdueshme mbi këtë çështje, qeveria e re për herë të parë paralajmëroi racionalizimin e përdorimit të automjeteve zyrtare. AQ ka identifikuar mangësi në Ligjin për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, i cili nuk i lejon Komisionit Zgjedhor Shtetëror të monitorojë si duhet zbatimin e këtij Ligji dhe u ka dërguar gjithë klubeve parlamentare iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e tij.

AQ ka filluar monitorimin e zbatimit të projektit të peticionit elektronik të Qeverisë, të titulluar “Zëri i qytetarëve”, i cili do të vazhdohet në vitin 2013. Pas periudhës fillestare të implementimit, Qeveria pranoi një pjesë të sugjerimeve të Aleancës Qytetare për përmirësimin e kësaj platforme.

Në kuadër të këtij programi, AQ ka krijuar partneritet me organizatat lokale në tri komuna. Me ta kemi arritur synime të përbashkëta që mbulojnë jugun, veriun dhe një pjesë qendrore të Malit të Zi. Të lidhura mirë, komunat do të shërbejnë si Platformë strukturore për punën mbi pjesëmarrjen dhe aktivizmin e qytetarëve nëpërmjet Programit të Qeverisjes së Mirë. Nëpërmjet të këtij programi, Aleanca Qytetare ka mbështetur organizatat partnere lokale dhe ka nicuar edhe një sërë aktiviteteve si: ka kremtuar njëzetë vjetorin e bllokadës në urën “Slijepaç most”, iniciativë kjo për shpalljen e territorit Valdanos në Ulqin si peizazh natyror i veçantë, pjesëmarrja në diskutime publike për procedurat mbi vlerësimin e ndikimit në mjedisin. Përmes organizatave partnere, ne mirëpresim qytetarët çdo ditë (nga 10h-14h) në Qendrën

Aarhus në Nikshiq dhe u ndihmojmë në çdo gjë që është në fushën e aktiviteteve të përmendura dhe në përputhje me Konventën e Aarhusit, si dhe u mundësojmë të gjithë të interesuarve të shohin elaboratet. Qëllimi afatgjatë i kësaj pjese të aktiviteteve tona është t'i përcjellim përvojat tona organizative në nivel lokal dhe t'i ndihmojmë qytetarët të fuqizojnë pozitën e tyre në trajtimin e çështjeve lokale të cilat janë jetike duke u përfshirë në mënyrë më aktive me to.

Në fund, do të donim të theksojmë se ne jemi krenar për faktin që AQ ka marrë pjesë në disa aktivitete humanitare. Të gjithë dhjetë të punësuarit e AQ nuk pinë duhan, kështu, kjo duhet të shërbejë si një model për të tjerët. Ne gjithashtu ndjekim parimet e Zyrës së gjelbër, sa më shumë që është e mundur.



Edin Kolenović, Koordinator i Qeverisjes së mirë

Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme të AQ në vitin 2012 ishin 204,374.57, ndërsa shpenzimet ishin 116,163.00 EUR. Pothuajse 95% e të ardhurave kanë qenë donacionet e donatorëve ndërkombëtarë. Gjatë 2012, AQ dhe konstituentët e saj arritën të përfitojnë mbështetjen e më shumë donatorëve për periudhë dy-vjeçare. Sasi e konsiderueshme e financave të marra gjatë vitit 2012, do të përdoret gjatë vitit 2013.

Gjatë periudhës kalimtare, mbështetje e rëndësishme financiare, administrative dhe programore për programet e AQ janë dhënë nga themeluesit e saj - 35mm dhe YIHR, dhe disa individë të cilët kërkuan të mbesin anonim.

Raporti i auditimit i AQ për vitin 2012 mund të shihet në faqen tonë të internetit.

Donatorët

Rockefeller Brothers Fund
Royal Norwegian Embassy
USAID Good Governance Activity in Montenegro/East West Management Institute
Charles Stewart Mott Foundation
Royal Netherlands Embassy
OSCE Mission in Montenegro
National democracy Institute (NDI)
Balkan Trust for Democracy
Council of Europe
EGAM
UNDP Office in Montenegro

Partnerët

Center for Democratic Transition (CDT)
Center for Democracy and Human Rights (CEDEM)
Monitoring group Ulcinj (MogUI)
Environmental movement OZON
Centar za prava djeteta (CPDCG)

Të punësuarit



Presidenti: Boris Raoniq
Drejtor i programit: Ajsha Haxhibegović
Drejtor egzekutiv: Edina Hasanaga Çobaj
Drejtor komunikimi: Darko M. Ivanović
Koordinator i Programit për të Drejta të Njeriut: Milan Radović
Koordinator i programit mbi Sundimin e Ligjit: Zoran Vujić
Koordinator i programit mediatik: Marina Bauk
Koordinator i programit të Qeverisjes së mirë: Edin Kolenović
Program Assistant: Sandra Gjonović
Office Manager: Jelena Vukoslavović
Ilogaritar: Gordana Drashković
IT manager: Jurica A. Zharković

Bashkëpunëtorë:
Konsulent juridik: Sinisha Bjeković
Jurist: Vladimir Bojić
Konsulent për Komunikime: Milica Gjokgurić

Monitoruesit:
Amela Jusović
Almir Caushević
Ana Topalović
Ismar Qorović
Andrej Gjeloshević
Bojana Toshić
Dalibor Vuksanović
Janko Axhić
Drazen Gjurashković
Ana Çabarkapa
Drazhen Petrić
Gjorgjije Perović
Emrah Jefkaj
Milica Zhugiq
Slobodan Tomashević